# DËSHMI ARKIVI

**A-458822**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | LaLiga - Barcelona përmbys Sevillan, Raphinha është thjesht fonemenal |
| ADRESA | `https://www.syri.net/sport/917922/barcelona-permbys-sevillan-raphinha-eshte-thjesht-fonemenal/` |
| BURIMI | syri.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 21:07:52 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 21:02:18 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3907d7cf4aeaf1fe3cbc48da07ecf68d65701d2bbba607631bc1e70a4a644507` |
| TEKSTI | `ca1e99b50b6e029c0721a7c4ce12d95fcc8de8b0b448918fff5dabdea36e0dd6` |
| PAMJA | `427dd8ba602bd158f9b910c45d3ed7cf745f419d55ac333b83d84d2454bd4013` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `fca5a1fc0958150f20c039eeafac48903c40161e9cb7b28bee3812d7f627163e` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `552a34f0419bb0f85ba237bcc1ccacbd9efdbebeb1d3d406ed195c7fa79d55c7` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/fca5a1fc0958150f20c039eeafac48903c40161e9cb7b28bee3812d7f627163e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px


ENVER ROBELLI
Qëndrimi i Zagrebit dhe heshtja e Tiranës


NDRIÇIM KULLA
Rama dhe Vuçiç, dy vëllezërit siamezë të dekadencës demokratike evropiane



# Barcelona përmbys Sevillan, Raphinha është thjesht fonemenal

23:02, 19/09/2026

Barcelona vijon serinë e rezultateve pozitive në LaLiga, teksa këtë herë triumfoi 3-1 në transfertë ndaj Sevilla-s. Katalanasit e nisën ndeshjen me një rast të madh, kur Lamine Yamal goditi shtyllën në minutën e 8-të me një gjuajtje nga distanca.

Vetëm një minutë më vonë, Sevilla kaloi në avantazh. Felix Correia dha një pasim të gjatë drejt zonës, ku Youssouf Fofana u shfaq i saktë me kokë, duke mposhtur portierin e Barcelonës për 1-0.

Reagimi i miqve ishte i menjëhershëm. Në minutën e 22-të, Raphinha kontrolloi bukur një pasim në hyrje të zonës dhe me një goditje të saktë në cepin e poshtëm riktheu baraspeshën, 1-1.

Barcelona pati mundësinë për të fituar një penallti në minutën e 35-të, kur Yamal u rrëzua në zonë pas një dueli, por arbitri vendosi të mos akordonte 11-metërsh.

Në pjesën e dytë, katalanasit përmbysën gjithçka. Në minutën e 52-të, Yamal dha një pasim të zgjuar në hapësirë për Raphinha-n, i cili me kokë e dërgoi topin në rrjetë për 2-1.

Nëntë minuta më vonë, Barcelona pësoi një shqetësim, pasi Andreas Christensen u dëmtua dhe u zëvendësua nga Gerard Martín.

Në minutën e 64-t, Raphinha ishte pranë 'tripletës', por goditja e tij nga këndi përfundoi në traversë.

Goli që vulosi fitoren erdhi në minutën e 79-të: Yamal gjeti sërish Raphinha-n në hyrje të zonës dhe braziliani realizoi me një parabël të bukur mbi portierin, duke vendosur shifrat përfundimtare 3-1.

Barcelona vazhdon të kryesojë me pikë të plota (21).

© SYRI.net

Lexo edhe:

Lazio fiton në transfertë ndaj Venezia-s, Zaccagni dhe Noslin i...

## më të lexuarat

Julian Alvarez rikuperohet në kohë, gati për derbin ndaj Real Madridit

'Dua Real Madridin në Champions'/ Intervista e Yamal: Si e bërtitura e Busquets më ndryshoi jetën

VIDEO/ Gol i pazakontë nga Mesi, argjentinasi fiton trofeun e radhës kundër meksikanëve

Eric Garcia zgjedh favorit për 'Topin e Artë': E meriton Lamine Yamal

Zyrtare: Chelsea ndryshon pronësinë, Todd Boehly largohet nga klubi

Benfika e mposhti Milanin me 'rezervat', Amorim në alarm: Nuk jam në gjendjen e duhur mendore


japin kreun Gattuso-s


Laporta sulmon Atletico-n për Julián Álvarez-in: E hoqën maskën


'Kartoni i kuq, momenti vendimtar', Osmani tregon ku çaloi Laçi pas humbjes nga Dinamo

Bëje LIKE dhe merr lajmin e fundit nga Sporti:

# Komentet

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto

pëlqen të flas për veten, 73 golat në sezon flasin vetë!

Arbër Hoxha largohet nga Dinamo Zagrebit, transferohet në Emiratet e Bashkuara Arabe

Messi do t'i japë lamtumirën Argjentinës në ndeshjen e 6 tetorit kundër Beninit

## TË NGJASHME

Daja pas fitores me Laçin: Vazhdimësia, elementi kryesor i mentalitetit fitues

Dortmundi ruan ecurinë perfekte, mposht Stuttgartin dhe ngjitet në krye

Dinamo nuk ndalet, mposht Laçin dhe feston fitoren e katërt radhazi

VIDEO/ Salah i bëhet makth Galatasaray-t, shënon tregolësh dhe feston me Muçin

Juventusi merr një goditje të rëndë, portieri dëmton ligamentin e kryqëzuar

Ahmataj analizon barazimin me Vorën: Terreni ndikoi, nuk bëmë ndeshjen tonë

Frankfurti dhe Freiburgu dhurojnë spektakël, por jo fitues, Bayerni i vetëm në krye



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.